



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 14 nëntor 2012

Nr. ref.: VMSP323/12

VENDIM PËR MOSPËRMBARIM

në

AKTGJYKIMIN e Gjykatës Kushtetuese, të 17 dhjetorit 2010

në

Rastin nr. KIo8/09

**Sindikata e Pavarur e Punonjësve të Fabrikës së Çelikut, IMK, në Ferizaj, e
përfaqësuar nga z. Ali Azemi, kryetar i Sindikatës – Vlerësim i
kushtetutshmërisë së Vendimit C. Nr. 340/2001, të 11 janarit 2002**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, Gjyqtar
Altay Suroy, Gjyqtar
Almiro Rodrigues, Gjyqtar
Snezhana Botusharova, Gjyqtare
Kadri Kryeziu, Gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, Gjyqtare

Parashtrues

1. Parashtrues është Sindikata e Pavarur e punonjësve të Fabrikës së Çelikut, IMK, nga Ferizaj. Në procedurën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) është e përfaqësuar nga kryetar i Sindikatës, z. Ali Azemi, me banim në Ferizaj.

Autoritetet zbatuese

2. Gjykata, në Aktgjykimin e saj të 17 dhjetorit 2010, vendosi: “[...] Vendimi i formës së prerë dhe i obligueshëm i Gjykatës Komunale në Ferizaj duhet përmbartuar nga ana e organeve kompetente, posaçërisht nga Qeveria dhe nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, si pasardhëse ligjore e AKM-së”. Gjykata, më tej, vendosi se Qeveria dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit janë autoritetet zbatuese.

Baza juridike

3. Neni 116 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), rregulli 56 dhe rregulli 63 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

4. Më 17 qershor 2011, Agjencia Kosovare e Privatizimit e informoi Gjykatën se “sipas nenit 9.5 të Ligjit për AKP nr. 03/L-067, Komisioni i Likuidimit i NSH IMK Ferizaj është pjesë integrale e AKP-së. Rrjedhimisht, Komisioni përkatës i likuidimit, në përputhje me dispozitat e Rregullores 2005/48 për likuidimin e ndërmarrjeve shoqërore, ka filluar me trajtimin e kërkesave kreditore sipas radhës prioritare të përcaktuar me nenin 44 të Rregullores nr. 2005/48 për Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve dhe Aseteve të tyre nën Autoritetin Administrativ të AKP-së”.
5. Më 4 tetor 2011, Gjykata Kushtetuese i dërgoi kërkesë Qeverisë së Republikës së Kosovës që të njoftonte Gjykatën Kushtetuese se çfarë veprimesh kishte ndërmarrë për të përmbartuar Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, në rastin KIO8/09, të 17 dhjetorit 2010. Qeveria e Republikës së Kosovës nuk i është përgjigjur deri më tani kësaj kërkesë të Gjykatës.
6. Më 16 dhjetor 2011, Agjencia Kosovare e Privatizimit, të cilës i ishte dërguar një kopje e kërkesës për Qeverinë, komentoi përkitazi me këtë, si në vijim:

“ ...

Komisionet e likuidimit, të themeluara pranë Agjencisë sipas ligjit të mëhershëm për Agjencinë Kosovare të privatizimit nr. 03/L-067, përfshirë edhe komisionin e

Likuidimit të NSH IMK Ferizaj kanë pushuar së vepruari me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri për Agjencinë Kosovare të Privatizimit nr. 04-L-034, në shtator të vitit 2011.

Rrjedhimisht, duke iu përgjigjur kushteve të reja ligjore të parapara me nenin 12 të Shtojcës së Ligjit nr. 04-L-034, Agjencia ka nisur procedurat e parapara ligjore për themelimin e Autoritetit përkatës të Likuidimit. Themelimi dhe emërimi i anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit bëhet në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik, prandaj duhet ndjekur procedurat lidhur me publikimin dhe njoftimet e nevojshme. Në momentin e themelimit të këtij autoriteti, puna do të fillojë në shqyrtimin e kërkesave të kreditorëve të NSH IMK Ferizaj.

Agjencia do të ju informojë me kohë me të gjitha veprimet që shkojnë në dobi të përmbushjes së Aktgjykimit K108/09.

...”

7. Më 19 dhjetor 2011, parashtruesi i kërkesës, z. Ali Azemi, kërkoi që Gjykata Kushtetuese të lëshonte një vendim në pajtim me rregullin 63 (6) të Rregullores së punës, që përcakton:

“Në rast të moszbatimit të një vendimi, ose të vonesës në dhënien e informacioneve për Gjykatën Kushtetuese për masat e ndërmarra, Gjykata Kushtetuese mund të lëshojë një vendim në të cilin do të theksohet që vendimi nuk është zbatuar dhe të vendosë për botimin e atij vendimi në Gazetën Zyrtare”.

8. Më 18 tetor 2012, Gjykata shqyrtoi dhe votoi Vendimin për mospërmbarim të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, të 17 dhjetorit 2010.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 3 mars 2009, parashtruesi parashtrroi një kërkesë në Gjykatë, duke kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së shkeljes së supozuar të parimit *res judicata* të përfshirë në nenin 31 [E drejta për gjykim të drejtë e të paanshëm] të Kushtetutës. Parashtruesi i kërkesës pohon se Gjykata Komunale e Ferizajt, e cila, me Aktgjykimin e 11 janarit 2002, ka miratuar kërkesën për kompensim të rrogave të papaguara të 572 punonjësve në ndërmarrjen shoqërore Fabrika për prodhimin e tubave të çelikut, IMK (në tekstin e mëtutjeshëm: IMK) në shumën 25.649.250,00 €. Ky Aktgjykim është bërë i plotfuqishëm (*res judicata*) më 11 mars 2002. Më 22 dhjetor 2005, e njëjta Gjykatë Komunale lejoi përmbarimin e Aktgjykimit. Megjithatë, përmbarimi deri më tani nuk është kryer.

10. Më 13 tetor 2010, është mbajtur një Seancë publike, ku përfaqësuesi i parashtruesve ishte i pranishëm, sikur edhe përfaqësuesit e AKP-së dhe IMK New CO. Gjithashtu, edhe Gjykata Komunale në Ferizaj, ishte e ftuar në Seancën publike, por ajo nuk i është përgjigjur ftesës. Të njëjtën datë, ishte dorëzuar dokumentacioni shtesë nga parashtruesi dhe nga AKP-ja.
11. Më 17 dhjetor 2010, Gjykata shqyrtoi dhe votoi për kërkesën.
12. Gjykata, në Aktgjykimin e saj të 17 janarit 2010, vendosi që, edhe përderisa mjetet juridike në dispozicion, sipas ligjit të zbatueshëm, janë shteruar nga punonjësit, këto mjete nuk kanë qenë efektive, në kuptimin që ato nuk i kanë sjellë rezultatet e pritura, sepse punonjësit ende janë duke pritur ekzekutimin e Vendimit të Gjykatës Komunale, të datës 11 janar 2002.
13. Përkitazi me këtë, Gjykata thekson që e drejta e inicimit të procedurës gjyqësore në raste civile, siç parashihet me nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës, si dhe me nenin 6 në lidhje me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), do të ishte iluzore, nëse sistemi ligjor i Kosovës do të lejonte një vendim gjyqësor përfundimtar dhe të plotfuqishëm që të mbetet i paefektshëm në dëm të një pale. Do të ishte e pakuptueshme që këto nene t'i përshkruajnë në hollësi garancitë procedurale që i ofrohen palëve në procedurë – procedura që janë të drejta, publike dhe ekspeditive – pa mbrojtjen e zbatimit të vendimeve gjyqësore. Interpretimi i neneve të lartpërmendura, si ekskluzivisht të lidhura me qasjen ndaj gjykatës, dhe administrimi e efektshmëria e procedurave, do të kishte mundësi të çonte në situata që nuk janë në përputhje me parimin e sundimit të ligjit, të cilin autoritetet e Kosovës janë të obliguara ta respektojnë (shih, *mutatis mutandis*, aktgjykimin e ECRtHR-së në rastin *Romashov kundër Ukrainës*, *Parashtresa nr. 67534/01*, aktgjykimi i 25 korrikut 2004).
14. Më tej, Gjykata vendosi, në Aktgjykimin e 17 dhjetorit 2010, se sundimi i ligjit, që është një prej parimeve themelore të një shoqërie demokratike, presupozon respektimin e parimit të sigurisë juridike, sidomos përkitazi me vendimet gjyqësore që kanë marrë formën *res judicata*. Asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një aktgjykimi përfundimtar dhe të plotfuqishëm, thjesht për qëllimin e fitimit të rishikimit dhe të rishqyrtimit të freskët të rastit (shih, për shembull, *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*, nr. 48553/99, § 72, ECHR 2002-VII, si dhe *Ryabykh kundër Ruisë*, nr. 52854/99, § 52, ECHR 2003-IX). Po të mos ishte kështu, kthimi prapa i vendimeve përfundimtare do të çonte në një klimë të përgjithshme të pasigurisë juridike, duke zvogëluar kështu besimin publik në sistemin gjyqësor, si dhe rrjedhimisht edhe në

sundimin e ligjit. Autoritetet kompetente, pra, kanë obligimin pozitiv që të organizojnë një sistem për zbatimin e vendimeve, i cili është efektiv edhe në kuptimin ligjor e edhe në atë praktik, si dhe i cili siguron zbatimin e tyre pa vonesa të panevojshme (shih, *Pecevi kundër Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 21839/03, 6 nëntor 2008; Martinovska kundër Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 22731/02, 25 shtator 2006*).

15. Në rastin konkret, parashtruesit nuk do të duhej të privoheshin nga përftimi i vendimit, i cili kishte marrë formën *res judicata* në favor të tyre.
16. Gjykata konkludoi se është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe efektiv, e garantuar me Kushtetutë dhe me GJEDNJ, sepse autoritetet përkatëse kanë dështuar që, për një periudhë kaq të gjatë kohore, të përmbarojnë Aktgjykimin e 11 janarit 2002.
17. Më 17 dhjetor 2010, Gjykata publikoi Aktgjykimin.

Përmbarami i Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese

18. Gjykata Kushtetuese (me Aktgjykimin në rastin KIO8/09, të 17 dhjetorit 2010) pranoi kërkesën e parashtruesit për vlerësim të kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj, Vendimi C. nr. 340/2001, të 11 janarit 2001.
19. Më tej, Gjykata ka vendosur se “[...] ka pasur shkelje të Nenit 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenet 6 [E drejta për gjykim të drejtë] dhe 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
20. Sa i përket zbatimit të Aktgjykimit të saj, Gjykata ka vendosur “[...] që vendimi i formës së prerë dhe i detyrueshëm i Gjykatës Komunale në Ferizaj duhet të përmbarohet nga autoritetet kompetente, në veçanti nga Qeveria dhe nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, si pasardhës ligjor i AKM-së”. Prandaj, siç theksohet në paragrafin 2 më lart, është e qartë se autoritetet zbatuese janë Qeveria dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit.
21. Gjithashtu, Gjykata ka vendosur se “[...] Qeveria dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit duhet të dorëzojnë në Gjykatë, brenda një periudhe gjashtëmujore, informata lidhur me masat e ndërmarra për ekzekutimin e këtij Aktgjykimi”.

22. Aktgjykimi i Gjykatës, KIo8/09, i 17 dhjetorit 2010, ka hyrë në fuqi menjëherë nga data 17 dhjetor 2010, që është gjithashtu datë e fillimit të afatit prej gjashtë muajsh që i është dhënë autoriteteve zbatuese për përmbarrimin e Aktgjykimit.
23. Gjykata Kushtetuese tani gjen se afati që i është dhënë autoriteteve zbatuese për përmbarrimin e Aktgjykimit të saj, në rastin KIo8/09, ka skaduar pothuajse qe dy vjet.
24. Sipas nenit 116.1 [Efekti juridik i vendimeve] të Kushtetutës, “Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës”.
25. Për më tepër, Gjykata rikujton se, në pajtim me rregullin 63 (2) të Rregullores së punës, “Të gjitha organet kushtetuese, si dhe gjykatat e autoritetet, janë të obliguara të respektojnë, të jenë në përputhje dhe të zbatojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese, brenda kornizës së kompetencave të tyre të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligj”.
26. Nga sa u tha më sipër, del se autoriteti zbatues nuk ka zbatuar ende Aktgjykimin final dhe të detyrueshëm të kësaj Gjykate, në rastin KIo8/09, të 17 dhjetorit 2010, përkundër nenit 116.1 të Kushtetutës, në lidhje me rregullin 63 të Rregullores së punës.
27. Në Aktgjykimin e saj, Gjykata vlerësoi se Qeveria dhe AKP-ja janë përgjegjës për përmbarrimin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese dhe kështu korrigoji shkeljen e të drejtave të njeriut të parashtruesit të kërkesës. Prandaj, duke u përmbajtur për gati dy vjet nga marrja e masave të nevojshme për t’iu përmbajtur Aktgjykimit final të detyrueshëm të Gjykatës Kushtetuese, në rastin konkret, ka pasur kështu shkelje nga autoriteti zbatues sa i përket obligimit të tyre kushtetues për të zbatuar Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, si dhe ka pasur shkelje të të drejtave të parashtruesve.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 116 të Kushtetutës, në pajtim me rregullin 56 dhe në pajtim me rregullin 63 të Rregullores së punës, më 18 tetor 2012, njëzëri

VENDOSI

- I. Të publikojë Vendimin për mospërmbarrim, për shkak se Qeveria dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit në Kosovë ende nuk kanë përmbarruar Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, KIo8/09, të 17 dhjetorit 2010;

- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve, Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Qeverisë;
- III. Në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit dhe për qëllime të rregullit 63 (6) të Rregullores së punës, ky vendim do të publikohet në Gazetën Zyrtare.

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani

